



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2717/ 6 prot

Datë.01.10.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1363/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.10.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes të ankesës së operatorit ekonomik “*Josh’s Tex*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-20474-09-18-2024, me objekt “*Blerje uniforme për personelin e Urgjencës Mjekësore*”, me fond limit 24,724,093 ( *njëzet e katër milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë e nëntëdhjetë e tre*) lekë pa TVSH ose 249.134 (*dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e katër*) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.09.2024 është 99.24), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Josh’s Tex*” SHPK, me NIPT J66702620Q, me adresa: Rruga “Ramazan Shijaku”, Pallati Konuda Alfa, nr. 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara.  
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”,Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.09.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-20474-09-18-2024, me objekt “Blerje uniforme për personelin e Urgjencës Mjekësore”, me fond limit 24,724,093 (njëzet e katër milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 249.134 (dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.09.2024 është 99.24), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 23.09.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4588 dhe me nr. 2717/2024 protokoll, datë 23.09.2024, i operatorit ekonomik “Josh’s Tex” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me pretendimet si vijon:

*Argumentim: Në DST në Shtojcën 5 formulari i specifikimeve teknike, artikujt (xhup dimeror, pantallona verore, pantallona dimerore, jelek) e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor janë produkte të certifikuara sipas Standarteve CE përkates. Koha e vënë në dispozicion për të siguruar lëndët e par ate artikujve sipas specifikave dhe konfeksionimin e kampionëve të kërkuara është e pamjaftueshme. Për sa i përket certifikimeve të produkteve theksojmë se, në shqipëri nuk ka trupa certifikuese CE për produktet. Të certifikosh produkte sipas standardit CE dhe normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471:2017, nevojitet minimalisht 5 deri në 8 javë pas konfeksionimit të produkteve. Të kërkoresh produkte të certifikuara për një periudhë kalendarike 30 ditore (19.09.2024 data e shpalljes së procedurës dhe 21.10.2024 data e paraqitjes së ofertave) është e pamundur të realizohet për një prodhues që nuk i ka të gatshëm artikujt. Në këtë mënyrë është e qarte që nga ky tender përjashtohen prodhuesit, eliminohet çdo lloj konkurrence dhe fituesi është i paracaktuar. Fituesi është ai që tashmë i ka të gatshëm këta artikuj. Duke na bërë të mendojmë që këtu nuk sigurohet një trajtim i barabartë dhe është diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik ,duke mos siguruar integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ndihehi të diskriminuar duke menduar që autoriteti e ka të paracaktuar fituesin .*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, nga një mostër për secilin prej artikujve objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5 të DST-së. Mostrat duhet të jenë të loguara sipas logos së kërkuar në specifikimet teknike, shtojca 5 e DST-së. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër emri i artikullit, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: iredhit «ollakuë,Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë). Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

*Kjo bie në kundërshtim me ligjin 162/2020, Neni 2, Neni 3, Neni 21, pika 1 dhe VKM 285 Datë 19.05.2021, Neni 40, pika 6.*

*Argumentim: Ky kriter bie në kundërshtim: Ky kriter është përcaktuar dhe i orientuar për pjesëmarrje vetëm për subjekte tregtare ose prodhues i mëparshëm i artikujve, duke përjashtuar rastin kur Operatori Ekonomik duhet të prodhojë artikujt objekt prokurimi, pra nuk ka produkte të gatshme të kataloguara por i prodhon artikujt e kërkuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu nënkuptohet që*

*specifikimet teknike që ndodhen në DST janë krijuar mbi bazën e artikujve tashme ekzistues dhe të kataloguar. Zotëruesi i tyre është fituesi i paracaktuar.*

*2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

*Konkluzion:*

*Duke parë dhe analizuar shkeljet e mësipërme shpresojmë në reagimin tuaj për anulimin e proáedurës dhe ribërjen e saj mbi baza ligjore.*

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3, të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 1290/6 prot, datë 30.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2717/3 prot, datë 01.10.2024, me objekt “Dërgim Vendimi”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me aktin e trajtimit të ankesës nr. 1290/5 prot, datë 27.09.2024 të operatorit ekonomik ankimues “Josh’s Text” SHPK, ku ka vendosur pranimin e saj me argumentat si vijon:

*Ne dokumentet Standarte te Tenderit, konkretisht ne piken 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3 Autoriteti Kontraktor ka cituar: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese, ne datën dhe orën e hapjes se tenderit, nga nje moster per secilin prej artikujve objekt prokurimi, ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara ne shtojcën 5 te DST-se. Mostrat duhet te jenë te loguara sipas logos se kerkuar ne specifikimet teknike, shtojca 5 e DST-së. Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete te ngjitur, e cila do te permbaje: moster “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertes se paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë te njejta me ato te ofruara nga operatori ekonomik ofertues ne dokumentacionin teknik te paraqitur ne sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do te paraqiten prane Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve te Pergendruara në daten dhe orën e hapjes se tenderit, me adrese: “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah te Gjykatës se Larte). Mungesa e mostres shte kusht skualifikues. Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, germa a) te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar te arsyeshme paraqitjen e mostrave per te gjitha artikujt objekt prokurimi, duke marre ne konsiderate sasine e tyre, velrën e fondit limit, specifikimet e ndryshme qe ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë te ketij kriteri, kerkohet qe te verifikohet perputhshmeria e*

specifikimeve teknike, kërkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin, sic është logo etj, të percaktuara në dokumentet e tenderit me artikujt e ofruara nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Mostrat e kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat e kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Në nenin 42 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Procedura e hapur", konkretisht pika 2 dhe 4 citohet: 2. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 35 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës. 4. Afati për dorëzimin e ofertave, percaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të shkurtohet me 5 ditë kur ofertat paraqiten me mjete elektronike. Në nenin 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Specifikimet teknike", pika 3 citohet: 1. Specifikimet teknike duhet të përshkruajne qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të percaktone objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të jera teknike të referimit, të percaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, perlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të percaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga falët "ose ekuivalenti i tij/saj" Në nenin 40 të VKM.285 datë 19.05.2021 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" pika 6, germa a) citohet: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kerkojë operatoreve ekonomike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentoj kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor percakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat e kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat e kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KSHA verën se publikimi i kontratës është bërë me datë 19.09.2024 dhe afati fundit për dorëzimin e ofertave dhe hapjen për vlerësim është vendosur të jetë me datë 21.10.2024, në përputhje të plote me afatet ligjore të percaktuara në nenin 42

te LPP, te sipercituar. Paraqitja e mostrave i sherben Autoritetit Kontraktor per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve te kerkuara per objektin qe prokurohet, me qillim qe, cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij. KSHA gjykon se, per autoritetin kontraktor e rendesishme eshte qe nepermjet specifikimeve teknike te percaktuara, te lejohet pjesmarria e nje numri te gjere konkurrentesh me qillim perfitimin e nje malli me performance te larte dhe kosto te ulët ndaj dhe mostrat jane kerkuar per te demonstruar standardin e cilesise qe ofrojne operatoret ekonomike ne menyre qe te jete e garantuar cilesia e produkteve te kerkuara. KSHA gjykon, se synimi baze i kerkeses se autoritetit kontraktor per kete procedure prokurimi eshte sigurimi i mallrave te kerkuara dhe permbushjes me sukses te kontrates, ne respektim te afateve te percaktuara ne LPP dhe RPP. Sa me siper, referuar pretendimit te ankimuesit dhe në mbeshtetje te Ligjit 162/2021 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 2 “Qellimi i ligjit”, gerrat c), ç), d), Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndermjet operatoreve ekonomike, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatoret ekonomike pjesemarrres si dhe perfitimin e mallit cilesor dhe me kosto sa me te ulët, gjykon, se ritja e afatit minimal per pranimin e ofertave duhet te zgjatet me 2 jave.

Per sa me siper, pretendimi i OE ankimues qëndron.

#### PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, indryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

#### VENDOSI

1. Pranimin e plote te ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik “JOSH'S TEX” SHPK.
2. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.
4. Ky vendim i joftohet menjehere Titullarit te Organit Qëndror Bleres.

#### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Josh’s Tex” SHPK, përsa i përketë kundërshtimit të kriterëve kualifikuese me arsyet: “Argumentim: NË DST në Shtojcën

5 formulari i specifikimeve teknike, artikujt (xhup dimeror, pantallona verore, pantallona dimerore, jelek) e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor janë produkte të certifikuara sipas Standarteve CE përkates. Koha e vënë në dispozicion për të siguruar lëndët e par ate artikujve sipas specifikave dhe konfeksionimin e kampionëve të kërkuara është e pamjaftueshme. Për sa i përket certifikimeve të produkteve theksojmë se, në shqipëri nuk ka trupa certifikuese CE për produktet. Të certifikosh produkte sipas standardit CE dhe normativave SSH EN ISO 13688:2013, SSH EN ISO 20471:2017, nevojitet minimalisht 5 deri në 8 javë pas konfeksionimit të produkteve. Të kërkosh produkte të certifikuara për një periudhë kalendarike 30 ditore (19.09.2024 data e shpalljes se procedurës dhe 21.10.2024 data e paraqitjes së ofertave) është e pamundur të realizohet për një prodhues që nuk i ka të gatshëm artikujt. Në këtë mënyrë është e qarte që nga ky tender përjashtohen prodhuesit, eliminohet cdo lloj konkurrence dhe fituesi është i paracaktuar. Fituesi është ai që tashmë i ka të gatshëm këta artikuj. Duke na bërë të mendojme që këtu nuk sigurohet një trajtim i barabartë dhe është diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik ,duke mos siguruar integritet, besim publik dhe transparencë në proáedurat e prokurimit publik. Ndihe mi të diskriminuar duke menduar që autoriteti e ka të paracaktuar fituesin.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, nga nje mostër për secilin prej artikujve objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5 te DST-së. Mostrat duhet të jenë të loguara sipas logos së kërkuar në specifikimet teknike, shtojca 5 e DST-së. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër emri i artikullit, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të përqëndruara në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: ìreshit «ollakuë,Godina Nr.6/337, tiranë (në krah të gjykatës së lartë). Mungesa e mostrës është kusht skualifikues. Kjo bie në kundërshtim me ligjin 162/2020, Neni 2, Neni 3, Neni 21, pika 1 dhe VKM 285 Datë 19.05.2021, Neni 40, pika 6. Argumentim: Ky kriter bie në kundërshtim: Ky kriter është përcaktuar dhe i orientuar për pjesëmarrje vetëm për subjekte tregtare ose prodhues i mëparshem i artikujve, duke përjashtuar rastin kur Operatori Ekonomik duhet të prodhojë artikujt objekt prokurimi, pra nuk ka produkte të gatshme të kataloguara por i prodhon artikujt e kërkuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Gjithashtu nënkuptohet që specifikimet teknike që ndodhen në DST janë krijuar mbi bazën e artikujve tashme ekzistues dhe të kataloguar. Zotëruesi i tyre është fituesi i paracaktuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konkluzion:Duke parë dhe analizuar shkeljet e mësipërme shpresojmë në reagimin tuaj për anullimin e proáedurës dhe ribërjen e saj mbi baza ligjore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 dhe 2.3.5 të “Kapacitetit Teknik” të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor, ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

**2.3.3** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, nga nje mostër për secilin prej artikujve objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 5 te DST-së.*

*Mostrat duhet të jenë të loguara sipas logos së kërkuar në specifikimet teknike, shtojca 5 e DST-së.*

*Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatorit ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).*

*Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).*

*Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.*

**2.3.5** *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë produktet e përzgjedhura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

III.1.2. Me shkresën nr. 1290/6 prot, datë 30.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2717/3 prot, datë 01.10.2024, me objekt “Dërgim Vendimi”, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Josh’s Tex” SHPK dhe ka vendosur pranimin e saj me argumentat si vijon:

*NE dokumentet Standarte te Tenderit, konkretisht ne piken 2.3 Kapaciteti teknik, pika 3 Autoriteti Kontraktor ka cituar: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese, ne datën dhe orën e hapjes se tenderit, nga nje moster per secilin prej artikujve objekt prokurimi, ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara ne shtojcën 5 te DST-se. Mostrat duhet te jenë te loguara sipas logos se kerkuar ne specifikimet teknike, shtojca 5 e DST-së. Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete te ngjitur, e cila do te permbaje: moster “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertes se paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë te njejta me ato te ofruara nga operatorit ekonomik ofertues ne dokumentacionin teknik te*



paraqitur ne sistemin e publikimeve elektronike (SPE). Mostrat do te paraqiten prane Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve te Pergendruara ne daten dhe orën e hapjes se tenderit, me adrese: "Reshit Collaku", Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah te Gjykatës se Larte). Mungesa e mostres shte kusht skualifikues. Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" te ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, germa a) te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar te arsyeshme paraqitjen e mostrave per te gjitha artikujt objekt prokurimi, duke marre ne konsiderate sasine e tyre, velrën e fondit limit, specifikimet e ndryshme qe ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë te ketij kriteri, kerkohet qe te verifikohet perputhshmeria e specifikimeve teknike, kerkesat teknike te aksesoreve që shoqerojne artikullin, sic eshte logo etj, të percaktuara ne dokumentet e tenderit me artikujt e ofruara nga operatori ekonomik pjesmarres. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) ditëve pas nënshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit. Ne nenin 42 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Procedure e hapur", konkretisht pika 2 dhe 4 citohet: 2. Per procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar, afati minimal per pranimin e ofertave ishte jo me pak se 35 dite nga data në te cilen eshte shpallur njoftimi i kontrates. 4. Afati per dorezimin e ofertave, percaktuar ne piken 2 te ketij neni, mund te shkurtohet me 5 dite kur ofertat paraqiten me mjete elektronike. Ne nenin 36 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Specifikimet teknike", pika 3 citohet: 1. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kerkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktone objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten; b) standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te jera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose perdorimin e produkteve; c) kerkesave ne terma funksionale sipas shkronjes "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjes "b" te kesaj pike, si mënyre qe nënkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale; ç) te dyja metodave te percaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikes 3 te ketij neni, për mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne të njejtin objekt kontrate. Çdo reference duhet te shoqerohet nga falët "ose ekuivalenti i tij/saj" Ne nenin 40 te VKM.285 date 19.05.2021 "Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave" pika 6, germa a) citohet: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, ge tregone se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndesi per vleresimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te argumentoj kerkesen per mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jenë ne kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Ne rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor percakton qarte proceduren per dorezimin e

mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori te interesar si dhe konfidencialitetin per pjesemarren ne proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjalë te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i thehen ofertuesit, me kerkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KSHA verën se publikimi i kontrates eshte bere me date 19.09.2024 dhe afati fundit per dorezimin e ofertave dhe hapjen per vleresim eshte vendosur te jete me date 21.10.2024, ne perputhje te plote me afatet ligjore te percaktuara ne nenin 42 te LPP, te sipercituar. Paraqitja e mostrave i sherben Autoritetit Kontraktor per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve te kerkuara per objektin qe prokurohet, me qillim qe, cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij. KSHA gjykon se, per autoritetin kontraktor e rendësishme eshte qe nepermjet specifikimeve teknike te percaktuara, te lejohet pjesmarria e nje numri te gjere konkurrentesh me qillim perfitimin e nje malli me performance te larte dhe kosto te ulët ndaj dhe mostrat jane kerkuar per te demonstruar standardin e cilesise qe ofrojne operatorët ekonomike ne menyre qe te jete e garantuar cilesia e produkteve te kerkuara. KSHA gjykon, se synimi baze i kerkeses se autoritetit kontraktor per kete procedure prokurimi eshte sigurimi i mallrave te kerkuara dhe permbushjes me sukses te kontrates, ne respektim te afateve te percaktuara ne LPP dhe RPP. Sa me siper, referuar pretendimit te ankimuesit dhe në mbeshtetje te Ligjit 162/2021 “Per prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 2 “Qellimi i ligjit”, germat c), ç), d), Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, me qellim nxitjen e pjesemarjes se operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi, nxitjen e konkurrences ndermjet operatoreve ekonomike, sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike pjesemarres si dhe perfitimin e mallit cilesor dhe me kosto sa me te ulët, gjykon, se ritja e afatit minimal per pranimin e ofertave duhet te zgjatet me 2 jave.

Per sa me siper, pretendimi i OE ankimues qëndron.

#### PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, indryshuar, Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

#### VENDOSI

1. Pranimin e plote te ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik “JOSH'S TEX” SHPK.
2. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.
4. Ky vendim i joftohet menjehere Titullarit te Organit Qëndror Bleres.

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, është rishikimi i kriterëve kualifikuese të përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe 2.3.5 të kapaciteteve teknike të dokumentave standarte të tenderit. Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si më sipër cituam, rezulton, se i ka pranuar pretendimet e ngritura nga ankimuesi në ankesë, ndaj dhe do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë

*prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Josh’s Text*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-20474-09-18-2024, me objekt “*Blerje uniforme për personelin e Urgjencës Mjekësore*”, me fond limit 24,724,093 ( njëzet e katër milion e shtatëqind e njëzet e katër mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 249.134 (dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e katër) Euro pa TVSH. (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 18.09.2024 është 99.24), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.10.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
  2. Autoriteti kontraktor brenda pesë ditëve të vë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me zbatimin e vendimit të KSHA-së nr. 1290/5 prot, datë 27.09.2024.
  3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “*Josh’s Tex*” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

